

“WVP Fund Management Tirana” sh.a.

Pasqyrat Financiare më dhe për

vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(me Raportin e Audituesit të Pavarur bashkëngjitur)

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	i-ii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	3
Pasqyra e Flukseve Monetare	4
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	5-26



RSM ALBANIA
Rr. Skender Luarasi, sheshi Gjenerali
Jozef San Martin, Pallati 3, Hyrja 19,
Tiranë, Shqipëri
T:+355 69 706 6110
www.rsm.global/albania

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë "WVP Fund Management Tirana" Sh.a.

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "WVP Fund Management Tirana" Sh.a. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2023, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital si edhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2023, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilisteve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencat auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë Administruese të fondeve "WVP Fund Management Tirana" Sh.a., përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur ne përputhje me nenet 17, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e Tjera të Shoqërisë për vitin 2023 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe te vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale.

Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Dashnor Çarçani
Auditues Ligjor




Albanian Audit Partners

Tiranë, 18 mars/2024



Elona Bisha
Auditues Ligjor



RSM Albania

Tiranë, 18 mars 2024



“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Pasqyra e Pozicionit Financiar

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek. përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Aktivet afatgjata			
Aktive Afatgjata Jomateriale	7	1,369,662	1,826,214
Aktive Afatgjata Materiale	8	2,513,687	1,367,568
Totali i Aktiveve Afatgjata		3,883,349	3,193,782
Aktivet Afatshkurtra			
Llogari të arkëtueshme dhe parapagime	9	2,523,075	4,269,982
Obligacione	10	26,400,241	21,685,956
Investime ne fonde		2,588,725	2,429,153
Mjete Monetare dhe ekuivalentët me to	11	1,275,351	4,396,482
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		32,787,392	32,781,573
Totali i Aktiveve		36,670,740	35,975,355
Kapitali			
Kapitali aksionar	12	28,600,000	28,600,000
Humbje të mbartura		1,920,246	1,405,382
Fitimi/(Humbja) e vitit		2,843,155	2,514,864
Totali i Kapitalit		33,363,401	32,520,246
Detyrimet			
Detyrimet Afatgjata			
Detyrimet e qirasë	13	491,448	378,845
Totali i detyrimeve afatgjata		491,448	378,845
Detyrimet e Qirasë	13	1,324,542	376,959
Detyrim tatim fitimi	22	94,235	259,117
Llogari të pagueshme	14	982,926	1,995,023
Llogari te tjera te pagueshme	15	414,188	445,165
Totali i detyrimeve afatshkurtra		2,815,891	3,076,264
Totali i Detyrimeve		3,307,339	3,455,109
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit		36,670,740	35,975,355

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 26 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtimi i Shoqërisë “WVP Fund Management Tirana” sh.a. më 26 shkurt 2024 dhe janë firmosur nga:

Z. Arton Lena
Administrator i Përgjithshëm

Znj. Rrezarta Qerimi
Kontabiliste

“WVP Fund Management Tirana” sh.a

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	Vitin i mbyllur me 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2022
Të Ardhura			
Të ardhura nga tarifat e administrimit	16	23,930,966	24,678,199
Të ardhurat nga interesat	17	1,141,780	1,084,796
Totali i të Ardhurave		25,072,746	25,762,995
Shpenzime			
Humbje nga ndryshimi i vleres se drejte te investimit ne fonde	18	21,948	(334,880)
Shpenzime për personelin	19	(3,907,686)	(4,209,944)
Shpenzime komisioni	20	(9,312,716)	(11,969,710)
Shpenzime të përgjithshme administrative	21	(6,504,026)	(4,606,463)
Shpenzime amortizimi	7,8	(945,877)	(1,327,917)
Total i Shpenzimeve Operative		(20,670,305)	(22,114,034)
Fitimi Operativ		4,424,389	3,314,081
Shpenzime Financiare			
Humbja nga kursi i këmbimit	22	(737,697)	(184,567)
Shpenzime interesi		(141,189)	(42,322)
Fitimi para tatimit		3,545,503	3,087,192
Tatim mbi fitimin	23	(702,348)	(572,328)
Fitimi neto pas tatimit		2,843,155	2,514,864
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		2,843,155	2,514,864

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 26 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

“WVP Fund Management Tirana” sh.a

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek. përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Kapitali i paguar	Humbje e mbartur	Humbje e periudhës	Totali
Gjendja më 1 janar 2022	28,600,000	(3,052,826)	5,014,092	30,561,266
Mbartja e humbjes së periudhës paraardhëse	-		44,116	44,116
Dividendet e shperndare			(600,000)	(600,000)
Fitim neto e vitit	-	-	2,514,864	2,514,864
Gjendja më 31 dhjetor 2022	28,600,000	(3,052,826)	6,973,072	32,520,246
Dividendet e shperndare	-	-	(2,000,000)	(2,000,000)
Fitim neto e vitit	-	-	2,843,155	2,843,155
Gjendja më 31 dhjetor 2023	28,600,000	(3,052,826)	7,816,227	33,363,401

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 26 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e Flukseve Monetare

		Viti i mbyllur më	Viti i mbyllur më
	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Fluksi parasë nga aktiviteti operacional			
Fitimi/(humbja) para tatimit		3,545,503	3,087,192
<i>Rregullime për:</i>			
Të ardhurat nga interesat	17	(1,141,780)	(1,084,796)
Shpenzime interesi		945,878	1,170,111
Shpenzime amortizimi	7,8	3,349,601	3,172,507
		3,545,503	3,087,192
<i>Ndryshimet në kapitalin qarkullues:</i>			
Rritje në llogari të arkëtueshme dhe parapagime	9	1,746,907	(2,391,365)
Rritje në llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme		(1,043,074)	2,000,021
Rrjedha e parasë e gjeneruar nga fluksi operacional		4,053,434	2,781,163
Interes i arkëtuar		1,141,780	1,084,796
Tatim fitim i paguar		(867,230)	(710,825)
Rrjedhja e parasë neto e gjeneruar në aktivitetin operacional		4,327,984	3,155,134
Shtesa të aktiveve afatgjata materiale	8	(1,635,444)	(260,963)
(Shtesa)/pakesime ne investime		(159,572)	334,880
(Shtesa)/pakesime në Obligacione		(4,714,285)	24,189
Rrjedhja e parasë neto e përdorur nga aktivitetet investuese		(6,509,301)	98,106
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese			
Pagese dividenti		(2,000,000)	(555,884)
Pagesa e Detyrimeve të Qirasë		1,060,186	(404,774)
Rrjedhja neto nga aktivite financuese		(939,814)	(960,658)
Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj		(3,121,131)	2,292,582
Mjete Monetare dhe ekuivalentë në fillim të periudhës		4,396,482	2,103,900
Mjete Monetare dhe ekuivalentë në fund të periudhës	12	1,275,351	4,396,482

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 26 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek. përveçse kur është shprehur ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

WVP Fund Management Tirana Sh.a (“Shoqëria”) është një shoqëri aksionare shqiptare me seli në Tiranë, e cila ka si objekt të veprimtarisë mbledhjen dhe investimin e fondeve të investimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.10198, date 10/12/2009 “Për sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” si dhe në përputhje me parimin e diversifikimit të riskut. Anëtarët e fondit marrin pjesë proporcionalisht në fitimet e fondit dhe gjithashtu mund të kërkojnë, në çdo kohë, shlyerjen e kuotave të tyre.

Shoqëria u regjistrua në Qendrën Kombëtare Shqiptare të Regjistrimit më 15 Nëntor 2017, dhe aktiviteti i saj rregullohet sipas neneve të ligjit nr.9901, datë 14 prill 2008, “Për shoqëritë tregtare” dhe në Ligjin nr. 10198, date 10.12.2009 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, dhe me aktet nënligjore të tij. Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në Rruga “Barrikadave”, nr. 118, kati 4, ap. 1.

Shoqëria është e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri bazuar në Licencën nr.4, datë 31 Janar 2018.

Shoqëria ka nën administrim fondin e investimit “WVP Top Invest” dhe fondin e investimeve me pjesëmarrje të hapur “WVP Global”, të cilët nuk janë entitete ligjore dhe nuk kane personalitet juridik.

- 1- **“WVP Top Invest”**, miratuar me datë 31.01.2018 me vendimin Nr. 14 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Fondi i Investimit “WVP Top Invest” ka filluar mbledhjen e ofertave fillestare për themelimin e tij gjatë muajit mars 2018. Mbështetur në Ligjin nr.10198, datë 10.12.2009, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar First Investment Bank (“Depozitari”) si bankë depozitare e “WVP Top Invest”.
- 2- **“WVP Global”**, miratuar me datë 23.10.2021 me vendimin Nr. 155 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Fondi i Investimit “WVP Global” ka filluar mbledhjen e ofertave fillestare për themelimin e tij gjatë muajit janar 2021. Mbështetur në Ligjin nr.10198, datë 10.12.2009, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar First Investment Bank (“Depozitari”) si bankë depozitare e “WVP Global”.

Më 31 dhjetor 2023 Shoqëria ka punësuar 5 punonjës (2022: 6). Numri mesatar i punonjësve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është 5 punonjës (2022: 5 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Bazat e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”). Ato janë autorizuar për tu raportuar nga drejtimi i Shoqërisë me 26 shkurt 2024.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë, duke qenë se drejtimi është i kënaqur se Shoqëria ka burime të përshtatshme për të vazhduar si një entitet me vijueshmëri për të ardhmen e parashikueshme.

Detajet e politikave kontabël të Shoqërisë, përfshirë ndryshimet në to, janë të paraqitura në Shënimin 4.

2.2. Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike përveç aktiveve financiare të mbajtura nëpërmjet fitim/humbjes të cilat janë paraqitur me vlerë të drejtë.

2.. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.2 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lekë”, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Përveç rasteve kur është shënuar ndryshe, informacioni financiar është paraqitur në lekë.

2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve kontabël

Vleresime kontabel

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të çmuara. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Shoqëria nuk ka vlerësime apo gjykime kontabël të rëndësishme përgjatë 2023.

2.4 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në bazë të vijimësisë, i cili supozon që shoqëria do të vazhdojë veprimtarinë operacionale dhe në periudhat në vazhdim. Shoqëria kryen në mënyrë frekvente provat e rezistencës për Fondin e investimit me qëllim përcaktimin e likuiditetit të nevojshme në kushte të tensionuara tregu. Ajo përcakton edhe impaktin që mund të kenë skenarët e ndryshëm të parashikuar në provat e rezistencës, në tarifën e administrimit të Fondit nga Shoqëria administruese. Këshilli i Administrimit të Shoqërisë gjatë vitit 2021 ka vendosur për krijimin e një fondi të ri investimi në monedhën Euro. Kjo vendimmarrje është miratuar nga Bordit i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me ane të vendimit Nr. 155, me datë 23.10.2021. Shoqëria, gjithashtu, vazhdon të ketë një situatë të kënaqshme likuiditeti ku aktivet afatshkurtra i tejkalojnë detyrimet afatshkurtra si rezultat i rritjes së vlerës së fondeve të saj nën administrim dhe në përgjithësi nuk është e financuar me borxhe nga palë të treta.

Bazuar në sa më lart, Drejtimi i Shoqërisë ka arritur në përfundim se nuk ka pasiguri të qenësishme në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë e saj në vijimësi, për të ardhmen e parashikueshme, prej të paktën 12 muajsh nga data e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare. Si rrjedhojë, Drejtimi gjykon se parimi i vijimësisë është bazë e përshtatshme në përgatitjen e këtyre pasqyrave.

3. Standarde të reja por jo në fuqi

Një numër standardesh të reja janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë pas 31 dhjetor 2023 dhe zbatimi i hershëm është i lejuar. Megjithatë, Shoqëria për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare nuk ka zbatuar paraprakisht standardet e reja dhe të amenduara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare dhe nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Këto standarde të reja dhe të rishikuara vijnë më poshtë.

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit dhe amendimet SNRF 17 Kontratat e Sigurimit.
- Shpalosjet e Politikave Kontabël (Amendimet për SNK 1 dhe Deklarate Praktike SNRF 2).
- Përcaktimet e Çmuarjeve Kontabël (Amendimet për SNK 8).
- Tatimi i shtyrë në lidhje me Aktive dhe Detyrime që lindin nga një Transaksion i Vetëm (Amendimet për SNK 12).
- Klasifikimi i Detyrimeve si afatshkurtër dhe afatgjatë (Amendimet për SNK 1).

4. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyer me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
EUR	103.88	114.23

4.2. Instrumentat Financiare

4.2.1. Njohja dhe çregjistrimi

Llogaritë e arkëtueshme dhe investimet në letrat me vlerë njihen fillimisht në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën në të cilën Shoqëria bëhet pjesë e marrëveshjes kontraktuale të instrumentit.

Aktivitet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivet financiare transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon. Gjithashtu, Shoqëria çregjistron një detyrim financiar, kur kushtet e tij janë modifikuar dhe flukset monetare të tyre janë thelbësisht të ndryshme dhe në këtë rast njihet një detyrim i ri financiar me vlerë të drejtë bazuar në kushtet e modifikuara. Me çregjistrimin e detyrimit financiar, diferenca midis vlerës kontabël të aktivitet që çregjistrohet dhe detyrimit të ri financiar me terma të modifikuara njihet në fitim ose humbje

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.2.2. Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Një aktiv financiar (përveç nëse është një kërkesë për arkëtim që nuk përmban një element të rëndësishëm financimi) ose detyrim financiar, në njohjen fillestare do të matet me vlerën e drejtë të tij plus ose minus, në rastin e elementëve të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, koston e transaksionit që i ngarkohet drejtpërdrejt blerjes ose emetimit. Një llogari e arkëtueshme pa një komponent financimi domethënes matet fillimisht me çmimin e transaksionit.

Aktivitetet financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPFH)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ).

Shoqëria aktualisht ka aktive financiare të klasifikuara me kosto të amortizuar dhe me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL).

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitetit financiar
- karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivitetet financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve zhvlerësimit të të arkëtueshmet tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera.

4.2.3. Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

i) Aktivitetet financiare me kosto të amortizuar

Aktivitetet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë paracaktuara si VDPFH):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto aktive maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kostoja e amortizuar reduktohet nga humbjet nga zhvlerësimi. Të ardhurat nga interesi, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose humbje.

ii) Aktivitetet financiare me VDPFH

Këto aktive maten më pas me vlerë të drejtë. Fitimet dhe humbjet neto, përfshirë ndonjë të ardhur nga interesi ose dividendi, njihen në fitim ose humbje.

iii) Aktivitetet Financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ).

Këto aktive maten më pas me vlerën e drejtë. Të ardhurat nga interesi përlogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Fitime dhe humbjet e tjera neto njihen në ATGJ. Në momentin e çregjistrimit, fitime ose humbje të akumuluar në ATGJ riklasifikohen në fitim ose humbje.

4.2.4. Detyrimet financiare - Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet

Detyrimet financiare klasifikohen si të matura me kosto të amortizuar ose me VDPFH. Një detyrim financiar klasifikohet si VDPFH nëse është i klasifikuar si i mbajtur për tregtim, është një derivativ ose është i krijuar si tillë që në njohjen fillestare. Detyrimet financiare me VDPFH maten me vlerë të drejtë dhe fitimet dhe humbjet neto, përfshirë ndonjë të shpenzim nga interesi, njihen në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare e tjera pas njohjes fillestare maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet e interesit dhe fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose në humbje.

4.2.5. Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditit - 'modelin e humbjeve të pritshme të kreditit (ECL)'.
'

Instrumentet financiare përfshinin kreditë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar, llogaritë e arkëtueshme, aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, aktivet e kontraktuara të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe angazhimeve të huasë dhe disa kontratave të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditit nuk varet me prej identifikimit të një ngjarje individuale të humbjes së kredisë mbi baze individuale. Në vend të kësaj, Shoqëria konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonnte aktivet financiare që kanë tregues objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kreditit '12 - mujore' njihen për kategorinë e parë, ndërsa 'humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetës së instrumentit' njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Shoqëria nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare me 31 dhjetor 2023.

4.3. Mjete monetare dhe ekuivalentë

Mjete monetare në arkë dhe bankë përfshin gjendjet monetare në arkë, paratë e vendosura në banka dhe investime mjaft likuide afat-shkurtra me maturitet më pak ose deri në tre muaj nga momenti i blerjes. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.4. Depozita me afat

Depozitat me afat janë vendosur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit dhe janë klasifikuar si të tilla ato me maturitet më shumë se tre muaj. Interesi është përlllogaritur në baza përlllogaritje dhe interesi i arkëtueshëm është pasqyruar në të arkëtueshme të tjera.

4.5. Aktive afatgjata materiale

i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi. Blerja e softëare-ve që janë të lidhur ngushtë me funksionalitetet e pajisjes përkatëse janë kapitalizuar si një pjesë e kësaj pajisje. Kur pjesët e një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçantë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

ii) Kosto të mëtejshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

iii) Zhvlerësimi

Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave me metodën e vlerës së mbetur. Aktivitet me qira zhvlerësohen për më të voglën mes periudhës së qirasë dhe jetëgjatësisë së dobishme.

Norma e amortizimit vjetor është si me poshtë:

Pajisje zyre	20%
Pajisje informatike	25%

4.6. Aktive të patrupëzuara

Aktivitet të patrupëzuara njihen me kosto historike, zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të këtij aktiviteti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, bazuar në metodën e vlerës së mbetur. Norma e amortizimit vjetor është 25%. Në vitin 2022, ka patur një ndryshim në vlerësimin kontabël përse i përket jetëgjatësisë, i aplikuar në perspektivë nga 15% në 25%, për arsye se reflekton më mirë gjenerimin e përfitimeve ekonomike të aktivitetit.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.7. Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhvlerësim. Nëse ka evidencë të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktiviteti ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme të aktivitetit. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave. Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti, ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuar të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin. Humbjet e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të vlerësuar nëse ka evidencë se rënia në vlerë është zbutur, ose nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke zbritur zhvlerësimin apo amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur më parë ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

4.8. Qiratë

Në fillimin e një kontrate, Shoqëria vlerëson nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata parashikon të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktiviteti të përcaktuar për një periudhë kohë në këmbim të një pagese.

Shoqëria e një aktiviteti me të drejtë përdorimi dhe detyrimin e qirasë në datën e fillimit të qirasë. Aktiviteti me të drejtë përdorimi matet fillimisht me kosto, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë, të rregulluar për të gjitha pagesat e qirasë të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare direkte që është kryer dhe një çmuarje të kostove për çmontimin dhe heqjen e përmirësimeve ose për të sjellë në gjendjen fillestare aktivitetin ose ambientin në të cilin ndodhen, neto nga ndonjë incentive qiraje të marre.

Aktiviteti më të drejtë përdorimi zhvlerësohet më pas nëpërmjet përdorimit të metodës lineare, nga data e fillimit deri në fund të afatit të qirase, vetëm nëse qiraja transferon pronesinë e aktivitetit në fjalë të Shoqërisë me perfundim të afatit të qirasë ose kosto e aktivitetit me të drejtë përdorimi reflekton faktin që Shoqëria do të ushtrojë një opsion blerjeje. Në këtë rast aktiviteti me të drejtë përdorimi do të zhvlerësohet përgjatë jetës së përdorimit të aktivitetit në fjalë, i cili përcaktohet me të njëjtën bazë si me ato të aktiveve afatgjata të trupezuara. Gjithashtu, aktiviteti me të drejtë përdorimi reduktohet për humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka, dhe rregullohet për rimatjen e detyrimit të qirasë.

Detyrimi i qirasë matet fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në datën e fillimit, të cilat skontohej duke përdorur normën e interesit të përfshirë në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet me lehtësi, normën rritëse të huamarrjes së bankës. Në përgjithësi, Shoqëria përdor normën rritëse të huamarrjes së bankës si normë interesi.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.8 Qiratë

Shoqëria përcakton normën e saj rritëse të huamarrjes duke analizuar huamarrjet e saja nga burime financimi të ndryshme të jashtme dhe bën rregullime të caktuara për të pasqyruar afatet e qirasë dhe llojin e aktivitet të marrë me qira.

Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Ajo rimatet nëse ka një ndryshim në pagesat e qirasë në të ardhmen që rezultojnë nga ndryshimi i indeksit ose normës, nëse ka një ndryshim në vlerësimin e Shoqërisë për shumën që parashikohet të paguhet në bazë të garancisë të vlerës së mbetur, nëse Shoqëria ndryshon vlerësimin e saj në lidhje me ushtrimin e opsionit të blerjes, zgjatjes së afatit ose perfundimit të kontrates ose nëse ka një pagesë të rishikuar të qirasë fikse në substancë.

Kur detyrimi i qirasë matet në këtë mënyrë, në vlerën kontabël të aktivitet me të drejtë përdorimi behet rregullimi përkatës, ose rregjistrohet në pasqyrën e fitim humjeve nëse vlera kontabël e aktivitet me të drejtë përdorimi zvogëlohet në zero.

Shoqëria paraqet aktive me te drejte përdorimi dhe detyrimet e qirasë në zera të vecantë financiarë të pasqyrës të pozicionit financiar

Qiratë afatshkurtra dhe aktivitet me vlerë të vogël.

Shoqëria ka vendosur të mos njohë aktivitet me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë, për qiratë e aktiveve me vlerë të vogël dhe qiratë afatshkurtra. Shoqëria njih pagesat e qirasë që shoqerohen me keto qira si shpenzime në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë.

4.9. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar paraqitet në vlerën e tij nominale. Kapitali aksionar i cili është i nënshkruar për emetim, por që ende nuk është i regjistruar është i paraqitur veçmas në pasqyrën e lëvizjes së kapitalit.

4.10. Përfitimet e punonjësve

(i) Kontributet shoqërore dhe shëndetësore të detyrueshme

Shoqëria paguan kontribute shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione.

4.11. Njohja e te ardhurave

Të ardhurat maten në bazë të kontratës së specifikuar me klientët. Shoqëria njih të ardhurat kur transferon kontrollin mbi një shërbim tek klienti.

Tarifa e administrimit llogaritet në baza ditore, si një përqindje e përcaktuar e vlerës neto të aktiveve të fondeve të Investimit.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.12. Tatimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave të tjera. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi, ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme sipas ligjit shqiptar të tatimit.

Tatimi i shtyrë është llogaritur nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e mbylljes së diferencave, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ky aktiv mund të përdoret. Aktiv i tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë impaktin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe tatimet dhe interesat shtesë. Shoqëria beson se përlllogaritjet për detyrimet tatimore janë të mjaftueshme për të gjithë vitet e hapura tatimore në bazë të vlerësimit të shumë faktorëve duke përfshirë interpretimet tatimore dhe eksperiencat e mëparshme.

4.13. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në fitim ose humbje gjatë përdorimit të shërbimit ose në datën në të cilën ato kanë ndodhur.

4.14. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare sipas SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë vlerësime, gjykime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumatat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme, të cilët besohet se janë të përshtatshëm dhe relevante për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhshme.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.14.1. Gjykime të rëndësishme kontabël

Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë të paraqitura më poshtë:

Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatim fitimin përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përbëhet nga tatimi i pritshëm i pagueshëm ose i arkëtueshëm mbi fitimin ose humbjen e vitit duke përdorur normat e tatimit në fuqi ose të cilat kanë hyrë në fuqi thelbësisht në datën e raportimit, dhe çdo sistemim i tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm për vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i Shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e perkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e mbylljes së diferencave, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatuueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ky aktiv mund të përdoret. Aktiv tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal. Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë impaktin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe tatimet dhe interesat shtesë. Shoqëria beson se përllogaritjet për detyrimet tatimore janë të mjaftueshme për të gjithë vitet e hapura tatimore në bazë të vlerësimit të shumë faktorëve duke përfshirë interpretimet tatimore dhe eksperiencat e mëparshme.

4.14.2. Çmuarjet

Informacioni rreth vlerësimeve dhe supozimeve që mund të kenë efektin më të rëndësishëm në njohjen dhe matjen e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve janë dhënë më poshtë. Rezultatet aktuale mund të jenë thelbësisht të ndryshme.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Shoqëria nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe dhënie informacionesh shpjeguese të miratuara nga vetë Shoqëria, të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, si për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime të matjes dhe prezantimit. Aty ku është e aplikueshme, informacionet e mëtejshme në lidhje me supozimet e bëra në përcaktimin e vlerave të drejta janë paraqitur në shënime specifike për atë aktivet ose detyrimet.

Drejtimi i Shoqërisë vlerëson që vlera e drejt e parasë dhe e parasë së ngurtësuar, llogarive të arkëtueshme, llogarive të pagueshme, aktiveve të tjera afatshkurtra dhe detyrimeve të tjera afatshkurtra dhe detyrimit për tatim fitimin, përafrohet me vlerën kontabël kryesisht për shkak të maturitetit afatshkurtër të këtyre instrumenteve.

Jetë e dobishme e pasurive të zhvlerësueshme

Drejtimi rishikon vlerësimin e tij të jetës së dobishme të pasurive të amortizueshme në çdo datë raportimi, bazuar në dobinë e pritshme të aktiveve. Pasiguritë në këto vlerësime kanë të bëjnë me vjetërsimin teknologjik që mund të ndryshojë dobinë programeve kompjuterike dhe pajisjeve informatike të caktuara.

5 Menaxhimi i rrezikut financiar

5.1. Faktorët e rrezikut financiar

Shoqëria monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar që lidhet me operacionet e saj përmes analizave të brendshme të rrezikut të cilat përshkruajnë shkallën dhe rëndësinë e rrezikut. Shoqëria nuk përdor instrumenta financiarë derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre risqeve. Shoqëria gjatë aktivitetit të saj ekspozohet ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- 1) Rreziku i kreditimit
- 2) Rreziku i likuiditetit
- 3) Rreziku i tregut
- 4) Rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, si dhe politikatat dhe procedurat për administrimin e këtyre risqeve.

5.2. Kuadri i Administrimit të Rrezikut

Politikat janë zhvilluar në bazë të strukturës së Fondit të Investimit dhe tolerancës së rrezikut të vendosur në politikën e investimeve. Skema e fondeve është e tillë që kontributet janë të përcaktuara, ndërsa përfitimet nuk janë të përcaktuara. Ndarja kryesore është që rreziku mbahet plotësisht nga klientët që kontribuojnë. Toleranca e rrezikut është elementi kryesor që përcakton diferencën midis fondeve nën administrim dhe që së bashku me skemën me kontribute të përcaktuara të fondit, qëndrojnë në thelb të zhvillimit të politikës së menaxhimit të rrezikut.

Për të menaxhuar rrezikun e tregut financiar, Shoqëria ndërmerr një proces që përbëhet nga identifikimi i ekspozimeve, vendosja e limiteve të lejuar të këtyre ekspozimeve, matjen e vazhdueshme të ekspozimeve, monitorimin e limiteve, dhe ekzekutimin e axhustimeve të duhura sado herë nivelet e ekspozimit gjenden jashtë intervaleve të caktuara.

5.3. Rreziku i kreditit

Emetuesit e instrumenteve financiare në portofol mund të dështojnë në pagesat e interesit ose kryegjësë. Rënia e cilësisë së kreditit mund të vijë nga rënia në vlerë dhe likuiditetit të instrumenteve të tregut. Një rritje në hapësirat e kredisë mund të ulë vlerën e tregut të instrumenteve duke sjellë një rënie të përgjithshme në vlerën neto të aktiveve të fondit.

Instrumentet financiare sipas kategorisë së vendit janë detajuar si më poshtë.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Pa vonesa dhe të pa zhvlerësuara		
Mjete monetare dhe ekuivalentë	1,275,351	4,396,482
Llogari të arkëtueshme	2,523,075	4,269,982
Investime ne fonde	2,588,725	2,429,153
Obligacione	26,400,241	21,685,956
Total	32,787,392	32,781,573

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

5.4. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një njësi ekonomike do të përballet me vështirësi për të përmbushur detyrimet që lidhen me pasivet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj nevojave të përditshme për burime monetare, kryesisht për të shlyer detyrimet e krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj normal. Drejtimi monitoron çdo ditë, javë dhe muaj duke bërë parashikime për flukset e parave.

Tabela më poshtë analizon detyrimet financiare sipas maturimit duke u bazuar në periudhën e mbetur nga data e raportimit deri në datën e maturimit sipas kontratës. Shumat e paraqitura në tabelën më poshtë janë flukset e parave të pa skontuara sipas kontratës. Balancat deri në 12 muaj barazohen me vlerën e tyre kontabël sepse ndryshimi me vlerën e skontuar nuk është i konsiderueshëm.

“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

5.4. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2023	Vlera kontabël	Flukset monetare	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	1 - 5 vjet	>5 vjet	E pa përcaktuar
Mjete monetare dhe ekuivalentë	1,275,351	1,275,351	1,275,351	-	-	-	-	-	-
Investime ne fonde	2,588,725	2,588,725	-	-	-	-	-	2,588,725	-
Obligacione	26,400,241	26,400,241	-	-	-	-	-	26,400,241	-
Llogari të arkëtueshme	2,523,075	2,523,075	2,523,075	-	-	-	-	-	-
Totali i aktiveve	32,787,392	32,787,392	3,798,426	-	-	-	-	28,988,966	-
Detyrimet monetare									
Llogari të pagueshme dhe të tjera	982,926	982,926	982,926	-	-	-	-	-	-
Detyrime të qirasë	1,815,990	1,815,990	40,954	122,862	122,862	122,862	1,406,450	-	-
Total i detyrimeve	2,798,916	2,798,916	1,023,880	122,862	122,862	122,862	1,406,450	-	-
Pozicioni neto	29,988,476	29,988,476	2,774,546	(122,862)	(122,862)	(122,862)	(1,406,450)	28,988,966	-
Efekti akumuluar			2,774,546	2,897,408	3,020,270	3,143,132	4,549,582	(24,439,384)	(24,439,384)
			Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	1 - 5 vjet	>5 vjet	E pa përcaktuar
31 dhjetor 2022									
Aktive Monetare									
Mjete monetare dhe ekuivalentë	4,396,482	4,396,482	4,396,482	-	-	-	-	-	-
Investime ne fonde	2,429,153	2,429,153	-	-	-	-	-	2,429,153	-
Obligacione	21,685,956	21,685,956	-	-	-	-	-	21,685,956	-
Llogari të arkëtueshme	4,269,982	4,269,982	4,269,982	-	-	-	-	-	-
Totali i aktiveve	32,781,573	32,781,573	8,666,464	-	-	-	-	24,115,109	-
Detyrimet monetare									
Llogari të pagueshme dhe të tjera	1,995,023	1,995,023	1,995,023	-	-	-	-	-	-
Detyrime të qirasë	755,804	755,804	30,555	61,110	91,665	91,665	480,809	-	-
Total i detyrimeve	2,750,827	2,750,827	2,025,578	61,110	91,665	91,665	480,809	-	-
Pozicioni neto	30,030,746	30,030,746	6,640,886	(61,110)	(91,665)	(91,665)	(480,809)	24,115,109	-
Efekti akumuluar			6,640,886	6,701,996	6,793,661	6,885,326	7,366,135	(16,748,974)	(16,748,974)

“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

5.5. Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përbëhet nga rreziku i normave të interesit dhe rreziku i luhatjes së kurseve të këmbimit.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Ekspozimet në monedhë të huaj përmbajnë rrezikun e lëvizjeve jo të favorshme në kursin e këmbimit. Aktivitet dhe detyrimet financiare në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2023 përbëhen si më poshtë.

Aktive	në LEK	në EUR	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalentë	604,975	670,376	1,275,351
Investime në fonde	2,588,725	-	2,588,725
Obligacione	20,569,016	5,831,225	26,400,241
Llogari të arkëtueshme	2,291,296	-	2,291,296
Totali aktiveve	26,054,012	6,501,601	32,555,613
Detyrime			
Llogari të pagueshme dhe të tjera	982,926	-	982,926
Detyrime të qirasë	-	1,815,990	1,815,990
Total i detyrimeve	982,926	1,815,990	2,798,916
Pozicioni neto	25,071,086	4,685,611	29,756,697

Aktivitet dhe detyrimet financiare në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2022 përbëhen si më poshtë.

Aktive	në LEK	në EUR	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalentë	985,403	3,411,079	4,396,482
Investime në fonde	2,429,153	-	2,429,153
Obligacione	21,685,956	-	21,685,956
Llogari të arkëtueshme	4,211,318	-	4,211,318
Totali aktiveve	29,311,830	3,411,079	32,722,909
Detyrime			
Llogari të pagueshme dhe të tjera	1,995,023	-	1,995,023
Detyrime të qirasë	-	755,804	755,804
Total i detyrimeve	1,995,023	755,804	2,750,827
Pozicioni neto	27,316,807	2,655,275	29,972,082

Analiza e ndjeshmërisë ndaj monedhave të huaja

			2023
	Shuma neto	+10%	-10%
EUR	4,685,611	468,561	468,561
			2022
	Shuma neto	+10%	-10%
EUR	2,655,275	265,528	(265,528)

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit, dhe një korigjim të vlerave të tyre është bërë për 10% ndryshim në kurset e këmbimit. Vlerat pozitive/negative tregojnë një rritje/ ulje të fitimit ose kapitalit, e cila ndodh kur Leku forcohet/ dobësohet ndaj një monedhe të huaj me +/- 10%.

5.6. Rreziku operacional

Rreziku operacional përbën rrezikun e humbjeve nga mos-funksionimi i sistemeve dhe i procedurave të brendshme. Shoqëria ka përpiluar procedura të brendshme dhe sisteme kontrolli për minimizimin e rrezikut operacional. Shoqëria ka krijuar sisteme të brendshme kontrolli që mënjanojnë mosfunksionimin e proceseve.

“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

6. Paraqitja me vlerë të drejtë

Vlerësimet e vlerave të drejta janë bazuar në paraqitjen e pozicionit financiar të instrumenteve ekzistuese financiare pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e aktiveve dhe pasiveve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë.

	Me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes	Me vlerën e drejtë përmes ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	Me kosto të amortizuar	Totali i vlerës kontabël	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2023					
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	-	-	1,275,351	1,275,351	1,275,351
Investime ne fonde	-	-	2,588,725	2,588,725	2,588,725
Obligacione	-	-	26,400,241	26,400,241	26,400,241
Llogari të arkëtueshme	-	-	2,523,075	2,523,075	2,523,075
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	-	-	(982,926)	(982,926)	(982,926)
Detyrime të qirasë	-	-	(1,815,990)	(1,815,990)	(1,815,990)
	Me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes	Me vlerën e drejtë përmes ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	Me kosto të amortizuar	Totali i vlerës kontabël	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2022					
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	-	-	4,396,482	4,396,482	4,396,482
Investime ne fonde	-	-	2,429,153	2,429,153	2,429,153
Obligacione	-	-	21,685,956	21,685,956	21,685,956
Llogari të arkëtueshme	-	-	4,269,982	4,269,982	4,269,982
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	-	-	(1,995,023)	(1,995,023)	(1,995,023)
Detyrime të qirasë	-	-	(755,804)	(755,804)	(755,804)

Matja e vlerës së drejtë përfshirë në informacionin shpjegues të pasqyrave financiare për 31 dhjetor 2023 dhe 2022 është bazuar në Nivelin 3 të hierarkisë.

“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

7. Aktive Afatgjata Jomateriale

Aktivët afatgjata jomateriale janë të përbëra si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Totali
<i>Kosto</i>		
Gjendja më 1 janar 2022	3,963,300	3,963,300
Shtesa	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	3,963,300	3,963,300
Shtesa	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	3,963,300	3,963,300
<i>Amortizimi i akumuluar</i>		
Gjendja më 1 janar 2022	(1,528,346)	(1,528,346)
Shpenzimi për vitin	(608,740)	(608,740)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	(2,137,086)	(2,137,086)
Shpenzimi për vitin	(456,552)	(456,552)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	(2,593,638)	(2,593,638)
<i>Vlera Neto</i>		
Më 1 janar 2022	2,434,954	2,434,954
Më 31 dhjetor 2022	1,826,214	1,826,214
Më 31 dhjetor 2023	1,369,662	1,369,662

8. Aktive Afatgjata Materiale

Aktivët afatgjata materiale janë të përbëra si më poshtë:

	Ndertesa	Pajisje Zyre	Pajisje kompjuterike	Totali
<i>Kosto</i>				
Gjendja më 1 janar 2022	2,025,283	184,921	1,127,100	3,337,304
Shtesa	-	-	187,500	187,500
Gjendja më 31 dhjetor 2022	2,025,283	184,921	1,314,600	3,524,804
Shtesa	1,386,907	47,900	200,637	1,635,444
Gjendja më 31 dhjetor 2023	3,412,190	232,821	1,515,237	5,160,248
<i>Amortizimi i akumuluar</i>				
Gjendja më 1 janar 2022	(705,428)	(92,687)	(639,944)	(1,438,059)
Shpenzimi për vitin	(556,223)	(18,445)	(144,509)	(719,177)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	(1,261,651)	(111,132)	(784,453)	(2,157,236)
Shpenzimi për vitin	(326,725)	(16,355)	(146,245)	(489,325)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	(1,588,376)	(127,487)	(930,698)	(2,646,561)
<i>Vlera Neto</i>				
Më 1 janar 2022	1,319,855	92,234	487,156	1,899,245
Më 31 dhjetor 2022	763,632	73,789	530,147	1,367,568
Më 31 dhjetor 2023	1,823,814	105,334	584,539	2,513,687

“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

9. Llogari të arkëtueshme dhe parapagime

Llogari te arketueshme dhe parapagime perbehen si vijon:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Të arkëtueshme nga Fondi Investimit	2,291,296	4,211,318
Shpenzime të parapaguara	13,118	13,118
Debitore dhe kreditore te tjere	67,538	45,546
Paradhenie per punonjesit	151,123	-
Totali	2,523,075	4,269,982

Të arkëtueshme nga Fondet përfaqësojnë vlerën e tarifës së administrimit të përllogaritur mbi aktivet neto të Fondit të Investimit, të cilat kanë mbetur të papaguar në fund të vitit.

10. Obligacione

Obligacionet e thesarit përbëhen nga obligacione të blera më 23.12.2020, me datë emetimi 28.07.2020 dhe datë maturimi 28.07.2030; obligacioni i blere më 22.09.2023 me date emetimi 23.02.2021 dhe date maturimi 23.02.2024; obligacioni i blere më 06.10.2023 me date emetimi 19.04.2017 dhe date maturimi 19.04.2027; obligacioni i blere më 18.05.2023 me date emetimi 26.05.2016 dhe date maturimi 26.05.2028; obligacioni i blere më 01.04.2021 me date emetimi 15.01.2021 dhe date maturimi 15.01.2031

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Obligacione	26,400,241	21,685,956
Totali	26,400,241	21,685,956

11. Mjete monetare dhe ekuivalentët me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Arka		
Leke	424,187	267,283
	424,187	267,283
Banka		
Llogari rrjedhëse		
Leke	180,274	38,843
EUR	670,376	3,411,079
	850,650	3,449,922
Depozitë pa afat		
Leke	514	679,277
	514	679,277
Totali	1,275,351	4,396,482

Llogarite rrjedhëse dhe depozitat pa afat janë te vendosura ne banka tregtare vendase te pa vlerësuar.

“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

12. Kapitali Aksionar

Më 31 dhjetor 2023, kapitali aksionar i regjistruar është 28,600,000 lekë, dhe përbëhet nga 13,000 aksione me vlerë nominale 2,200 lekë (2021: Kapitali aksionar 28,600,000 Lekë). Struktura aksionare bazuar në kapitalin e paguar tërësisht dhe të regjistruar ishte si vijon:

	31 dhjetor 2023			31 dhjetor 2022		
	Në %	Numër aksionesh	Në Lek	Në %	Numër aksionesh	Në Lek
WVP Fund Management AD Shkup	51.00%	6,630	14,586,000	51.00%	6,630	14,586,000
"WVP"- "NDERMJETESIM NE SIGURIME"	25.00%	3,250	7,150,000	25.00%	3,250	7,150,000
Arton Lena	12.31%	1,600	3,520,660	12.31%	1,600	3,520,000
Rubert Strobl	4.00%	520	1,144,000	4.00%	520	1,144,000
Kujtim Ibraimi	4.69%	610	1,341,340	4.19%	545	1,199,000
Ardian Kelmendi	2.50%	325	715,000	2.50%	325	715,000
Ognen Tilikj				1.00%	130	286,000
Vjollca Mirashi	0.50%	65	143,000			
Totali	100%	13,000	28,600,000	100%	13,000	28,600,000

Kjo strukturë është aprovuar nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është regjistruar në QKB.

13. Detyrimet e qirase

Detyrimet e qirasë sipas maturitetit paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Detyrime Afatshkurtra	491,448	378,845
Detyrime Afatgjata	1,324,542	376,959
Totali	1,815,990	755,804

Shoqëria ka marre me qira ambientet ku zhvillon aktivitetin e saj kryesor. Shoqëria ka vetëm një kontratë qiraje për të cilën ka njohur aktivin e të drejtës së përdorimit.

Tabela e mëposhtme tregon levizjet në detyrimet e qirase, si rezultat i interesit, fitim/humbje nga kursi i kembimit dhe pagesave të qirase:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Gjendja me 1 janar	755,804	1,160,578
Interesi	141,188	42,322
Fitim/humbje nga kursi i kembimit	(23,435)	(82,550)
Shtesa të afatit të qirase	1,386,908	
Pagesat e qirase	(444,475)	(364,546)
Gjendja me 31 dhjetor	1,815,990	755,804

“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

14. Llogari të pagueshme

Llogari të pagueshme detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Vjollca Mirashi	327,224	645,778
Valmira Tace	343,240	544,186
Milushi Bajram	12,260	322,618
Primiera7 Invest euro	218,148	239,883
Adem Trezhnjeva	12,021	166,549
RSM Albania	-	32,786
Hotel Mondial	22,849	29,870
Hotel Doro City	7,687	8,453
Vodafone Albania	-	4,900
Bloomberg	4,155	-
Oltiana Hoti	9,767	-
Silvia Marku	3,429	-
AG 12	22,146	-
Total	982,926	1,995,023

15. Llogari te tjera te pagueshme

Llogari të tjera të pagueshme detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Paga të Pagueshme	130,934	-
Të pagueshme për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore dhe TAP	107,947	74,783
Tatim në burim	175,307	370,382
Total	414,188	445,165

16. Të ardhura nga tarifa e administrimit

Të ardhura nga tarifat e administrimit detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Të ardhura nga komisionet e hyrjes (Entry Fee)	15,396,390	17,495,572
Të ardhura nga komisionet e administrimit të Fondeve	8,534,576	7,182,627
Totali	23,930,966	24,678,199

17. Të ardhura nga interesi

Të ardhurat nga interesi detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Të ardhura nga interesi i investimeve në letra me vlerë	1,140,753	1,077,098
Të ardhura nga interesi i depozitave	1,027	7,698
Totali	1,141,780	1,084,796

“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

18. Humbje nga ndryshimi i vleres se drejte te investimit ne fonde

Humbje nga ndryshimi i vleres se drejte te investimit ne fonde vjen si rezultat i ndryshimit te vleres se kuotes ne daten 31 dhjetor 2023 dhe detajohet si me poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022
Fitim/(humbje) nga ndryshimi i vleres se drejte te investimit ne fonde	21,948	(334,880)
Totali	21,948	(334,880)

19. Shpenzime për personelin

Shpenzimet për personelin detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022
Shpenzime personeli	3,907,686	4,209,944
Totali	3,907,686	4,209,944

20. Shpenzime komisioni

Shoqëria për të realizuar shitjet e aksioneve dhe kuotave të fondeve që ajo administron, ka nënshkruar kontrata me agjent të licencuar. Ato kundrejt tarifave të përcaktuara, mundësojnë shërbimin e shitjeve të aksioneve ose kuotave të fondeve të investimit, veprojnë si agjent për klientët në rast kur ka kërkesë për blerje nga këta të fundit si dhe kryejnë promovimin e fondeve që shoqëria administron.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022
Shpenzime komisioni për agjentet e marketingut	9,312,716	11,969,710
Totali	9,312,716	11,969,710

21. Shpenzime të përgjithshme administrative

Shpenzime të përgjithshme administrative detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022
Shpenzime për koncesione, patenta, licenca dhe të ngjashme	912,919	997,038
Shpenzime për kontabilitet dhe auditim	1,060,242	836,616
Shërbim konsulence financiare dhe menaxheriale	-	211,644
Trajnime	1,353,606	554,501
Shpenzime Kancelarike	337,841	168,300
Shpenzime për shërbimet bankare	245,399	171,316
Transferime, udhëtime, dieta	1,125,907	1,167,752
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	818,229	240,757
Taksa dhe tarifa vendore	74,500	74,500
Shpenzime Noteriale	9,800	18,860
Shpenzime të tjera	565,583	165,179
Totali	6,504,026	4,606,463

“WVP Fund Management Tirana” sh.a
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek. përveçse kur është shprehur ndryshe)

22. Humbje nga kursi i këmbimit

Shoqëria për vitin 2023 rezultoi me një humbje nga kursi i këmbimit si më poshtë:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2022
Fitim nga kursi i këmbimit	109,531	68,269
Humbje nga kursi i këmbimit	(847,228)	(252,836)
Fitim nga kursi i këmbimit, neto	(737,697)	(184,567)

23. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Fitimi neto llogaritur si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Humbja Bruto	3,545,503	3,087,192
<i>Shpenzime të panjohura</i>		
Shpenzime amortizimi nga aplikimi IFRS 16	326,725	141,961
Shpenzime interesi nga aplikimi IFRS 16	141,189	42,322
Shpenzime të tjera të panjohura	1,113,380	908,591
	1,581,294	1,092,874
<i>Shpenzime të zbritshme</i>		
Pagesat e qirasë	444,475	364,546
Humbje e mbartur	-	-
Baza e llogaritjes së Tatimit	4,682,322	3,815,520
% e tatimit Fitimit	15%	15%
Tatim Fitimi	702,348	572,328

Detyrimi për tatimin fitimit përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2022
Teprica në fillim të vitit	259,117	-
Parapagim Tatim Fitimi	(867,230)	(313,211)
Shpenzim Tatim Fitimi i periudhës	702,348	572,328
Teprica në fund të vitit	94,235	259,117

24. Transaksionet me palët e lidhura

Palë e lidhur konsiderohet një person apo një entitet që ka kontroll apo kontroll të përbashkët mbi Shoqërinë, ka aftësinë të ushtrojë influencë të konsiderueshme mbi Shoqërinë në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale, është anëtar i personelit të drejtimit kyç të Shoqërisë apo të një Shoqërie mëmë të Shoqërisë, si dhe është pjesë e të njëjtit grup me Shoqërinë, është filial, investim në pjesëmarrje apo shoqëri mbi të cilën Shoqëria ushtron kontroll apo influencë të konsiderueshme. Gjithashtu konsiderohet palë e lidhur një shoqëri që ka një sipërmarrje të përbashkët me Shoqërinë apo dy entitete të cilat janë sipërmarrje të përbashkëta të një shoqërie të tretë. Një numër i caktuar transaksionesh me palë të lidhura janë ndërmarrë gjatë aktivitetit operacional të shoqërisë. Këto transaksione janë bërë sipas afateve dhe normave të tregut.

Volumi i këtyre transaksioneve dhe balancat në fund të periudhave respektive janë si vijojnë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Aktive		
Mjete Monetare në First Investment Bank	851,163	3,590,850
Të arkëtueshme nga Fondi i Investimit	2,291,296	-
Të ardhura		
Të ardhura nga Interesat First Investment Bank	1,141,780	1,078,554
Shpenzime		
Shpenzime për komisione First Investment Bank	245,399	167,269
Shpenzime për shpërblimet e drejtimit	1,839,900	1,865,967

25. Ngjarje pas datës së raportimit

Drejtimi i shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje pas datës së aprovimit të pasqyrave financiare e cila mund të kërkojë rregullime ose shënime shtesë në këto pasqyra financiare.